



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:072288

Datë: 09.08.2021

Numri i dokumentit: 02071633

P.nr.8/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të akuzuarit 1. M.T i akuzuar për shkak të 8 veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe 2. A.G për shkak të veprës penale në vazhdim Blerje, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprave penale nga neni 345 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr. 1067-1/17, të datës 26.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më datë 13.07.2021 në praninë e Prokurorit të Shtetit Paulin Pashku, të akuzuarve, më datë 15.07.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 09.08.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: M.T nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati Xh... e ëma M... e gjinisë Sh..., beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar edhe më parë.

I akuzuari: A.G nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati M... dhe e ëma N... e gjinisë F..., me numër personal, ka të kryer fakultetin Ekonomik, punon në "...", i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë.

I

I akuzuari M.T në bazë të nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

LIROHET NGA AKUZA

I. Sepse më datë 10.04.2017, në kohë të pacaktuar, në fshatin Nikaj, në vend punimet e autostradës Prishtinë Hani Elezit, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjellë përftim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës ka hapur rezervarin e kamionit dhe ka marrë naftë, pronë e të dëmtuarës "...", me ç'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

II. Sepse me datë 14-16.04.2017, në kohë të pacaktuar, në fshatin ... Komuna Kaçanik, saktësisht në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit R. D., me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjellë përftim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që më përdorimin e forcës ka hapur revoravrin e traktorit .. dhe ka marrë rreth 30 litra si dhe disa çelësa të cilat ishin të vendosura në traktorë, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

III. Sepse me datë 23.04.2017, rreth orës 03-40, në fshatin Bob Komuna e Kaçanikut, në vend punimet e autostradës Prishtinë - Hani Elezit, me qëllim që më përvetësimin e sendeve të luajtshme vetit t'i sjellë përftim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që më

përdorimin e forcës ka hapur rezervarin e gjeneratorit dhe ka marrë naftë rreth 40 litra, pronë e të dëmtuarës "...", me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

IV. Sepse me datë 22-23.04.2017, në kohë të pacaktuar në fshatin Vatë, Komuna e Kaçanikut, saktësisht në oborrin e shtëpisë së dëmtuarit I. Gj., me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t' sjellë përfitim pasuror ka hapur rezervarin e ekskavatorit e kompanisë ".." dhe nga mjeti - valaku, ka marrë rreth 80 litra naftë, me ç 'rast të dëmtuarit, i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

V. Sepse me datë 01.05.2017, në kohë të pacaktuar, në fshatin Bob Komuna e Kaçanikut, në vend punimet e autostradës Prishtinë Hani Elezit, konkretisht në "...", me qëllim që më përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës ka tentuar të hapë automjet pune (Grenda), ashtu që me të mbushur një bidonë të plastikës me 20 litra naftë, vërehet nga roja, ku edhe arrin të ik nga veni i ngjarjes,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së

VI. Sepse me datë 03.05.2017, në kohë të pacaktuar, në fshatin Soponicë Kaçanik, në vend punimet e autostradës Prishtinë –Hani Elezit, konkretisht në "...", me qëllim të përvetësimit e sendeve të luajtshme vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës e ka hapur rezervarin e gjeneratorit dhe ka marrë naftë rreth 80 litra, me ç 'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

VII. Sepse me datë 03-04.05.2017, në kohë të pacaktuar në fshatin ... Komuna Kaçanik, saktësisht në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit R. K. me qëllim që më përfitimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë më me përdorimin e forcës ka hapur rezervarin e traktorit "...” dhe ka marrë rreth 20 litra naftë, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

VIII. Sepse me datë 10.05.2017, në kohë të pacaktuar, në fshatin Nikaj Kaçanik në vend punimet e autostradës Prishtinë Hani Elezit, konkretisht në "...” me qëllim që më përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës e ka hapur rezervarin e ekskavatorit dhe ka marrë naftë pronë e të dëmtuarës, me ç ‘rast i ka shkaktuar dëm material,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

IX. Sepse me datë 10-11.05.2017 në kohë të pacaktuar në Kaçanik, Rrugën “Hamzë Jashari”, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që më përdorimin e forcës ka hapur rezervarë e kamionëve dhe ekskavatorit dhe ka marrë naftë rreth 450 litra, pronë e të dëmtuarit D. R., me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm materil,

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së

II

I Akuzuari A.G:

ËSHTE FAJTOR

Sepse gjatë muajit Maj të vitit 2017, në fshatin Nikaj Komuna e Kaçanikut, si pronar i pompës së derivateve të naftës "...", nga i mituri L.T në 4 raste të ndryshme ka blerë 270 litra naftë me çmim 0.50 centë, duke e ditur se nafta e blerë është rezultat i kryerjes së veprës penale.

Me të cilat veprime ka kryer veprën penale në vazhdim Blerje, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 41, 45, 50, 51, 81, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve (një qind e tetëdhjetë ditëve), i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i akuzuari në afat prej 2 viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

II. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest civil.

III. Detyrohet i akuzuari A.G që në emër të shpenzimeve procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaje shumën prej 20 €, si dhe për Fondin për Kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1067-1/17 të datës 26.12.2018, kundër M.T për shkak të 8 veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të KPRK-së dhe 1 veprë penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe 2. A.G për

shkak të 8 veprave penale në Blerje, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprave penale nga neni 345 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata me datë 30.06.2021, 13.07.2021 ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor në të cilin ishin prezent prokuroria e shtetit dhe të akuzuarit M.T dhe A.G në të cilat shqyrtime është bërë procedimi i provave lidhur me këtë çështje penale juridike.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokuroria e Shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se ne bazë të provave të cilat u nxjerrën në shqyrtim gjyqësor e në veçanti në seancën e shqyrtimi gjyqësor, posaçërisht duke ju referuar dëshmisë së L.T, mbrojtjes së akuzuarve dhe pjesërisht dëshmisë së dëshmitarit B. K., prokurori i shtetit në bazë të këtyre provave vlerëson se është vërtetuar dispozitivi i aktakuzës dhe vepra penale e cila i vihet në barrë të pandehurave, dëshmitari L.T. ashtu si kurse në deklaratën e dhënë në polici me datë 29.05.2017 dëshmon se ditën kritike me 10.04.2017 kishte shkuar në punëtorinë e “...” prej nga siç pretendon ky dëshmitarë nga rojet e sigurimit kishte blerë sasi të konsiderueshme të naftës dhe pasi që nuk ka mundur ta bartë vetë e ka ftuar tani të pandehurin M.T që të i ndihmojë, të njëjtën provë e vërteton edhe vetë M.T në mbrojtjen e tij e cilën nuk e mohon se në garazhën e shtëpisë së tij është gjetur sasia e naftës së vjedhur, nuk e mohon po ashtu se L. T. e kishte ftuar për të shkuar për ti ndihmuar që ta bartë naftën, po ashtu nga mbrojtja e që pandehurit në seancën e sotme i njëjti po ashtu dëshmon se L... i kishte thënë se sasinë e naftës së vjedhur që tani të pandehurit A.G, po ashtu që tani të pandehurit A.G vërtetohet se i njëjti e ka ditur se dëshmitari L. T. naftën e kishte marrë ose siç thotë i akuzuari e kishte blerë në “...” dhe më pas këtë sasi të naftë ja ka shitur si kompensim për një borgj të mëhershëm që ja ka pasur A.G, ku i pandehuri A... thotë se këtë sasi të naftës e kishte blerë për 70 cent litrin, nga vetë mbrojtësja e të pandehurave dëshmia e dëshmitarit L.T. dhe pjesërisht edhe dëshmia e dëshmitarit B. K. i cili në dëshminë e tij theksoi se në vendin e ngjarjes kishte gjetur 3 kanta të derivateve, prokurori i shtetit konsideron se të gjitha këto prova jo vetëm se ndërlidhen me njëra tjetrën po qartazi vërtetojmë përgjegjësinë penale të pandehurve sipas pikave të aktakuzës, mbrojtjen e të pandehurit M.T sidomos në pike ku i njëjti pretendon se nuk ka vjedhur naftë por vetëm i ka ndihmuar L... për ta bartur dhe pas të njëjtën sasi të naftës e kishte mbajtur në garzhdën e shtëpisë së tij dhe sidomos se kompania ... nga ku është vjedhur sasia e naftës nuk është kompani e cila tregton

me naftë këto fakt vendimtare bëjnë përgjegjës të pandehurit për vepra e tyre të kryera në mënyrën e përshkuar si në dispozitivin të aktakuzës sepse në raport më të pandehurin Mentor farë qarë shihet se i njëjti i ka kontribuar kryerjes së veprës penale në bashkëkryerje fillimisht duke e bartur naftën e më pas duke e fshehur në garazhdin e shtëpisë së tij, po ashtu po e theksoj se i njëjti pandehur në mbrojtjes e tij farë qartë e thekson se L.T e ka për qëllimi që atë sasinë e naftë të ja shes atni të pandehurit A.G, në raport me të pandehurin A.G prokuroi i shtetit e thekson se ky i pandehur në vetë mbrojtjen e tije e thekson se e ka ditur se origjina e naftës që ja kishte sjellur L T. është prej kompanisë ..., siç dihet siç fakt botërisht kompania ... nuk është kompani që tregton derivate por është kompani e ndërtimit , rrjedhimisht kjo rrethanë tregon se i pandehuri A.G e ka ditur fare mirë se kjo naftë është e vjedhur për arsyeje se i njëjti për nga cilësitë e tij, se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë duke punuar në pompë të benzinës i njëjti rrjedhimisht ka qenë i njoftuar me çmimin e tregut të naftë e po ashtu edhe për mënyrat e furnizimit të rregullt më naftë, po ashtu duke e marrë parasysht faktin se dëshmitarit L.T në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i mitur kjo rrethanë e përforcon dhe më tepër diapozitivin a e aktakuzës në raport më të pandehurin A.G i cili nuk e ka pasur të vështir që ta dijë se një i mitur nuk mund të sjellë rreth 235 litra naftë në mënyrë të ligjshme një sasi të karburanteve e aq më pak të bejë të besueshme që këtë sasi e karburanteve është përfituar në mënyrë të ligjshme andaj i propozoj gjykatës që në vlerësimin e merituar të provave dhe duke e përfshirë edhe përmbajtjen e mesazheve telefonike të i shpall të pandehurit fajtorë dhe ti dënoj në mënyrë të paraparë më ligj duke gjetur njëkohësisht edhe rrethana tjera qofshin lehtësuese apo renduese.

I Akuzuari M.T gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e kësaj vepre penale dhe ka deklaruar se un vetëm e kam ndihmuar në një rast L. T. për ta bartur naftën dhe un asnjëherë nuk kam kryer këto vepra siç akuzohem, dhe për këtë rast jam dënuar në Ferizaj të gjyqtari I. I.”, dhe un L. T. vetëm e kam ndihmuar dhe e ka pru naftën te un në garazhe.

- I akuzuari A.G gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se naftën e ka blerë prej L.T dhe asnjëherë nuk kam blerë naftë prej M.T, naftën që e kam blerë prej L.T e kam blerë për arsyeje se L.T më ka pasur rreth 170 € borgj mua, dhe më ka ofruar naftën për ta blerë në kompensim të borgjit që e ka pasur ndaj meje, ndërsa un kam pranuar se nuk ka pasur ndonjë zgjidhje tjetër për të më e kthyer borgjin që më ka pasur L.T.

Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëshmitari U. M. i cili ka dëshmuar se:

Un kam qene si roje e punës ne kompaninë “ ..” dhe un kam dalë jashtë me kolegun e punës I. K. dhe e kena vërejtur gjeneratorin qe është i shkyçur dhe dritat janë te fikura dhe kam pare disa persona te panjohur dhe në atë moment që e kam vërejtur e kam njoftuar policinë, te njëjtit me kanë sulmuar dhe me kanë goditur me thikë, dhe nuk kam pasur mundësi me i vërejte se ka qenë shumë terr, e në atë dite jam larguar nga ai vend i punës, rezervarët e agregatit dhe skipit kanë qenë te hapura, nuk kamë mundur të identifikoj personat që kanë qenë.

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëshmitari I. K. i cili ka dëshmuar se:

Un kamë qenë duke punuar si roje në kompaninë “ ...” në ora 01:00 të natës, i kemi dëgjuar disa zhurma kur kanë hipur mbi cisterna të cilët kanë vjedhur naftë dhe akumulatorë, ka qenë natë dhe me sy nuk i kemi parë dhe kanë qenë të armatosur dhe këtë e kemi vërejtur se kanë gjuajtur në ajër për te mos i shkuar nga mbrapa dhe menjëherë ka ardhur policia, largësia nga vetura ka qenë rreth 50 metra, dhe nuk kemi mundur me identifikua sepse kanë pasur kapela dhe ka qenë natë, nuk e di sa dhe çfarë dëmi është shkaktuar.

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëmtuari-dëshmitari R. K. i cili ka dëshmuar se:

Un nuk e kam parë askënd në vendin e ngjarjes, nafta mu ka marrë nga traktori rreth 20 litra,

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëmtuari-dëshmitari R. D. i cili ka dëshmuar se:

Un i kam vërejtur te nesërmen kur shkova me dhezë traktorin e pash se kishte qenë rezervari i traktorit i hapur dhe i dëmtuar dhe disa qelësat i kishin marrë nga traktori dhe 2 i kam gjetur në rrugë dhe më ishin marrë rreth 30 litra naftë, dhe në ekskavatorë kanë tentuar të vjedhin mirëpo nuk kanë mundur te hapin rezervarin, dhe nuk e kamë parë asnjë person.

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëmtuari-dëshmitari R.M i cili ka dëshmuar se:

Ne e kemi bërë një kontratë me pronarin I. Gj. për kryerjen e disa punime ne oborrin e shtëpisë, punimet i kemi deri ne ditën e shtunë dhe në mbrëmje me urdhër te pronarit na ka thënë që mjetet te parkohen para ndriçimit afër hyrjes se shtëpisë dhe natyrisht të dielën nuk punojmë si kompani dhe kemi pauzuar dhe di kund te dielën rreth orës 09:00 të mëngjesit me thirr në telefon pronari I. Gj. dhe me njofton se ka naftë te derdhur në tokë, dhe të cilat janë vjedhur prej cilindrit 30 litra dhe prej bagerit 50 litra naftë, dhe i ftuam policinë dhe me policinë i kemi hulumtuar gjurmët dhe e kemi zbuluar me policinë sipas gjurmëve te naftës deri në rrugën e Tetovës, nuk kamë dyshime në askënd.

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëmtuari-dëshmitari D. R. i cili ka dëshmuar se:

Un kam punuar tërë ditën si shofer i kamionit, dhe kur kamë shkuar në mëngjes e kam parë që kamioni nuk e ka pasur baterinë aty dhe rezervarin e naftës ka qenë i hapur te cilin e kemi pasur te parkuar ne rrugën “...” afër mekanik L..., nuk e kam parë dhe nuk kam dëgjuar se kush i ka vjedhur.

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëmtuari-dëshmitari B.K i cili ka dëshmuar se:

Un kam punuar si sigurim në kompaninë “...” ku i kemi ruajtur mjetet e punës, ka ndodhur një rast i vjedhjes, i kam parë kantat dhe kapakun e mjetit kamionit që ka qenë i qelët, dhe e kam lajmëruar policinë dhe shefat e mijë, kam qenë duke punuar në ndërrim të natës, dhe punishtja ka qenë rreth 100 metra e gjatë dhe e gjerë 20 metra dhe ka pasur rrugëdalje nuk ka qenë e rrethakuar.

- Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar dëshmitari L.T i cili ka dëshmuar se:

Un e kam thirrur M.T që lidhur me naftën që e kam blerë në “...” për të më ndihmuar, dhe ideja ka qenë e imja për të blerë naftën dhe pastaj e kam ftuar M... për të më ndihmuar, naftën e kam blerë prej rojeve brenda në vend punishte, dhe kam blerë rreth 3 kanta nga 20-25 litra dhe kam paguar rreth 50-60 cent litrën, M... brenda në vend punishte nuk ka hyrë”, Naftën ia kam shitur A.G dhe mentori nuk ka qenë aty.

Gjykata me pëlqimin e palëve konform 383 paragrafi 1 nën par 1.3 ,në shqyrtim gjyqësor të datës 13.07.2021 e lexoi deklaratën e dëshmitarit G. B. të dhënë në polici me datë 03.05.2017.

- Në fazën e administrimit të provave janë administruar:

Deklarata e M.T të dhënë në polici 21.08.2018, Deklarata e L.T të dhënë në polici e datës 29.05.2017, Deklarata e F. N.t e dhënë në polici e datës 29.05.2017, Deklarata e A.G e dhënë në polici e datës 25.05.2017, U lexua dhe shikuan 6 fotografi të SMS-ve, Raporti fillestar i incidentit e datës 10.04.2017, Raporti i oficerit I. A. e datës 10.04.2017, U shikuan 12 fotografi, Vërtetim mbi dorëzimin e gjësendeve i datës 24.04.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 16.04.2017, Raporti i oficerit F.S i datës 16.04.2017, Deklarata e dëshmitarit B.K e datës 10.04.2017, Deklarata e dëshmitarit R. D. e datës 16.04.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 23.04.2017, Raporti i oficerit I. B. i datës 23.04.2017, Deklarata e dëshmitarit U.M e dhënë në polici e datës 22.04.2017, U shikuan një fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 23.04.2017, Raporti i oficerit Sh. K i datës 23.04.2017, Raporti i dëshmitarit R.M të dhënë në polici i datës 23.04.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 01.05.2017, Raporti i oficerit Y. Sh. i datës 01.05.2017, Deklarata e dëshmitarit XH.S e dhënë në polici e datës 01.05.2017, U shikuan pesë fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 03.05.2017, Raporti i oficerit G. H. i datës 03.05.2017, u shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 05.05.2017, Raporti i oficerit XH.L i datës 05.05.2017, Deklarata e dëshmitarit R. K. e dhënë në polici e datës 05.05.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 10.05.2017, Raportit i oficerit I. B. i datës 10.05.2017, Deklarata e dëshmitarit Isuf Kuka e dhënë në polici e datës 10.05.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 11.05.2017, Raporti i oficerit I. A. i datës 11.05.2017, Deklarata e dëshmitarit D. R. e dhënë në polici e datës 11.05.2017, U shikua 4 fletë me fotografi.

Pa pyetje dhe pa vërejtje.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet për të akuzuarin M.T

Gjykata në bazë të provave të administruara në shqyrtim gjyqësor ka gjetur se nuk është vërtetuar se i akuzuari M.T ka kryer 8 vepraat penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së të KPRK-së si në dispozitivin e aktakuzës.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar një nga një dhe të gjitha bashkërisht të gjitha provat që janë administruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor, ku pas analizimit të të gjitha këtyre provave, ka ardhur në këto përfundime:

Se për të akuzuarin M.T nuk është provuar se e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar gjykata erdhi në përfundim pas dëgjimit të dëshmitareve U.M, I.K., R. K., R. D., R.M, D. R., B.K dhe L.T të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe administrimit të provave.

Dëshmitari U.M, gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, në rastin kur ka ndodhur vjedhja në vend punishte nuk ka arritur të identifikoj se personat që kanë kryer vjedhjen dhe më kanë sulmuar.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv. Po ashtu i dëmtuari-dëshmitari, nuk i ka parë drejtpërdrejtë personat që e kanë kryer vjedhjen dhe që e kanë sulmuar,

Dëshmitari Isuf Kuka, gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, në rastin kur ka ndodhur vjedhja në vend punishte nuk ka arritur të identifikoj se personat që kanë kryer vjedhjen e naftës dhe akumulatorët.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv. Po ashtu i dëmtuari-dëshmitari, nuk i ka parë drejtpërdrejtë personat që e kanë kryer vjedhjen,

Dëshmitari R. K., gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, nafta është vjedhur nga traktori rreth 20 litra dhe nuk ka identifikuar asnjë person.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv. Po ashtu i dëmtuari-dëshmitari, nuk i ka parë drejtpërdrejtë personin që e ka kryer vjedhjen,

Dëshmitari R. D., gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, në rastin kur ka ndodhur vjedhja ditën e nesërmen e ka vërejtur që ka qenë i hapur

rezervari i traktorit dhe i kanë munguar disa çelësa që i ka pasur në traktor, ndërsa kanë tentuar të hapin rezervarin e ekskavatorit mirëpo nuk kanë mundur, dhe nuk i ka parë drejtpërdrejtë personin që e ka kryer vjedhjen.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv. Po ashtu i dëmtuari-dëshmitari, nuk e ka parë drejtpërdrejtë personin që e ka kryer vjedhjen.

Dëshmitari R.M, gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, në rastin kur ka ndodhur më ka njoftuar pronari që kemi qenë duke i kryer punimet në oborrin e shtëpisë së tij I. Gj., më ka thirr të dielën më ka njoftuar se ka naftë të derdhur në tokë dhe në të cilin rast më janë vjedhur 30 litra naftë prej cilindrit dhe 50 litra naftë prej bagerit nuk ka dyshime për asnjë person që e ka kryer këtë vjedhje.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv. Po ashtu i dëmtuari-dëshmitari, nuk e ka parë drejtpërdrejtë personin që e ka kryer vjedhjen.

Dëshmitari D. K., gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, punon si shofer i kamionit dhe në mëngjes e ka parë që kamioni nuk e ka pasur baterinë aty dhe rezervari i naftës ka qenë i hapur, dhe nuk i ka parë dhe nuk ka dëgjuar për personin që e ka kryer vjedhjen. Po ashtu i dëmtuari-dëshmitari, nuk e ka parë drejtpërdrejtë personin që e ka kryer vjedhjen.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv.

Dëshmitari B.K, gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, në rastin e vjedhjes ka qenë duke punuar si roje e sigurimit në kompaninë “Rojet e Nderit” gjatë vëzhgimit të mjeteve që i ka pasur duke i ruajtur ka vërejtur se në njërin kamion kanë tentuar të vjedhin naftë, ku i ka gjetur 3 kanta afër rezervarit të kamionit në të cilën njëra kishte qenë e mbushur me naftë ndërsa dy të tjerat kanë qenë të zbrazura, dhe nuk ka parë drejtpërdrejtë ndonjë person që ka tentuar të kryejnë vjedhjen. Po ashtu nuk e ka parë drejtpërdrejtë personin që e ka kryer vjedhjen.

Nga kjo dëshmi të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv.

Dëshmitari L.T, gjatë dëshmisë së tijë të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe deklaratës së dhënë në polici, heksuar se e ka ftuar M.T për naftën që e kam blerë në “...” për të më ndihmuar, dhe naftën un e kam blerë prej rojeve që kanë punuar në “...” me çmim prej 50-60 centë për litër naftë, dhe afërsisht i kam blerë 3 kanta nga 20-25 litra, naftën e kam blerë në vend punishte të ... dhe ideja ka qenë e imja ndërsa M... e kam ftuar vetëm për të më ndihmuar për ta bartë naftën dhe vetëm un kam hyrë në vend punishte, ndërsa naftën e blerë e kam shitur te A.G me çmim prej 0.50 centë litrën, dhe në rastet që e kam shitur naftën M.T nuk ka qenë i përfshirë në këto raste, dhe për këto raste të vjedhjes jam gjykuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Nga kjo dëshmi e dëshmitarit nuk është arritur të dëshmohet se i akuzuari M.T ka kryer veprën penale si në dispozitiv. Po ashtu dëshmitari, e thekson se i akuzuari M... vetëm e ka ndihmuar në një rast, ndërsa dëshmitari në këtë rast është gjykuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Departamenti për të Mitur dhe nuk ka dëshmuar se për cilin rast konkret bëhet fjalë, duke mos dhënë asnjë detaj të datës ose muajit për të cilën është kryer ajo vepër.

Po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga provat tjera si transkriptove të bisedave telefonike në mes të dëshmitarit L.T dhe të akuzuarit A.G në të cilat raste konstatohet se naftën të cilën e ka vjedhur L.T e ka kontaktuar të akuzuarin tjetër A.G për shitjen e naftës dhe në asnjë rast tjetër nuk është provuar se i akuzuari M.T ka shitur naftë te i bashkë akuzuari A.G.

Po ashtu gjykata i analizoi dhe vlerësoi edhe provat tjera si: deklaratën e dëshmitarit G. B. të dhënë në polici me datë 03.05.2017, Raporti i oficerit F.S i datës 16.04.2017, Deklarata e dëshmitarit B.K e datës 10.04.2017, Deklarata e dëshmitarit R. D. e datës 16.04.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 23.04.2017, Raporti i oficerit I. B. i datës 23.04.2017, Deklarata e dëshmitarit U.M e dhënë në polici e datës 22.04.2017, U shikuan një fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 23.04.2017, Raporti i oficerit Sh. K. i datës 23.04.2017, Raporti i dëshmitarit R.M të dhënë në polici i datës 23.04.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 01.05.2017, Raporti i oficerit Y. Sh. i datës 01.05.2017, Deklarata e dëshmitarit XH.S e dhënë në polici e datës 01.05.2017, U shikuan pesë fletë me fotografi,

Raporti fillestar i incidentit i datës 03.05.2017, Raporti i oficerit G. H. i datës 03.05.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 05.05.2017, Raporti i oficerit XH.L i datës 05.05.2017, Deklarata e dëshmitarit R. K. e dhënë në polici e datës 05.05.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 10.05.2017, Raportit i oficerit I. B. i datës 10.05.2017, Deklarata e dëshmitarit I. K. e dhënë në polici e datës 10.05.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 11.05.2017, Raporti i oficerit I. A. i datës 11.05.2017, Deklarata e dëshmitarit D. R. e dhënë në polici e datës 11.05.2017, U shikua 4 fletë me fotografi nga të gjitha këto si dhe dëshmitë e dëshmitarëve nuk është provuar se i akuzuari M.T ka kryer veprat penale sikur në dsipozitiv, për shkak se në asnjë rast asnjë prej dëshmitarëve nuk e ka identifikuar si kryerës apo me asnjë provë tjetër nuk është arritur të provohet se i njëjti i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Baza ligjore.

Pas vlerësimit të provave dhe vërtetimit ta faktit se për të akuzuarin nuk ka prova se i ka kryer veprat për arsyet e cekura më lartë, gjykata bazuar në nenin 364 pika 1.3 të KPP-së ka vërtetuar se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet për të akuzuarin A.G.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar një nga një dhe të gjitha bashkërisht të gjitha provat që janë administruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor ku pas analizimit të të gjitha këtyre provave, ka ardhur në këto përfundime:

Sepse gjatë muajit Maj të vitit 2017 në kohë të pacaktuar në 4 raste i akuzuari A.G ka blerë naftë nga L.T rreth 270 litra të cilën e ka paguar me 50 cent për litër u vërtetua nga dëshmia e dëshmitarit L.T i cili pasi që i kishte pasur një borgj të pandehurit A.G, i' a ka shitur naftën me çmim nën minimumin e çmimit të tregut.

Po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga provat tjera, transkriptove të SMS, në të cilët kanë biseduar L.T dhe i akuzuari A.G dhe kanë bërë marrëveshje për kohën, sasinë dhe çmimin e naftës dhe mënyrën deri te transporti i naftës.

Faktin se i akuzuari A.G në 4 raste ka blerë naftë rreth 270 litra me çmim nën mesataren e tregut prej 50 centë litrën nga L.T është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit L.T të dhënë në polici dhe në shqyrtim gjyqësor.

Faktin se i akuzuari A.G ka kryer veprën penale në vazhdimësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është vërtetuar dhe nga mbrojtja e tij në shqyrtim gjyqësor i cili nuk e mohon që e ka kryer veprën penale si në dispozitiv.

Po ashtu gjykata i analizoi dhe vlerësoi edhe provat tjera si: Raporti i oficerit F.S i datës 16.04.2017, Deklarata e dëshmitarit B.K e datës 10.04.2017, Deklarata e dëshmitarit R. D. e datës 16.04.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 23.04.2017, Raporti i oficerit I. B. i datës 23.04.2017, Deklarata e dëshmitarit U.M e dhënë në polici e datës 22.04.2017, U shikuan një fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 23.04.2017, Raporti i oficerit Sh. K. i datës 23.04.2017, Raporti i dëshmitarit R.M të dhënë në polici i datës 23.04.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 01.05.2017, Raporti i oficerit Y. Sh. i datës 01.05.2017, Deklarata e dëshmitarit XH.S e dhënë në polici e datës 01.05.2017, U shikuan pesë fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 03.05.2017, Raporti i oficerit G. H. i datës 03.05.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 05.05.2017, Raporti i oficerit XH.L i datës 05.05.2017, Deklarata e dëshmitarit R. K. e dhënë në polici e datës 05.05.2017, Raporti fillestar i incidentit i datës 10.05.2017, Raportit i oficerit I. B. i datës 10.05.2017, Deklarata e dëshmitarit I. K. e dhënë në polici e datës 10.05.2017, U shikuan tre fletë me fotografi, Raporti fillestar i incidentit i datës 11.05.2017, Raporti i oficerit I. A. i datës 11.05.2017, Deklarata e dëshmitarit D. R. e dhënë në polici e datës 11.05.2017, U shikua 4 fletë me fotografi, vërtetojnë faktin se i akuzuari A.G e ka kryer veprën penale si në dispozitiv.

Gjykata konform nenit 360 par 2 të KPP- së sipas detyrës zyrtare ndryshoi përshkrimin faktik të veprës penale sa i përket kohës së kryerjes së veprës penale dhe personin me të cilin i akuzuari e ka kryer veprën penale, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, si dhe kualifikimin juridik veprës penale nga vepra penale Blerje, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprave penale nga neni 345 paragrafi të KPRK-së, në veprën penale në vazhdim Blerje, pranim ose fshehja e

sendeve të përfituara me kryerjen e veprave penale nga neni 345 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 81 të KPRK-së

Elementet e veprës penale

Me të gjitha provat të cilat gjykata i ka vlerësuar si të besueshme është vërtetuar se i akuzuari A.G në mënyrë të kundërligjshme, në kohë, mënyrë dhe në vazhdimësi e ka kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara nga kryerja e veprës penale, me të cilat veprime plotësohet figura e veprës penale nga neni 345 par 1 të KPRK- së

I akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën e ka ditur se është përfituar me kryerjen e veprave penale, plotësohet figura e veprës penale nga neni 345 par 1 të KPRK-së.

I akuzuari e ka kryer veprën penale në vazhdimësi edhe atë në 4 rastë ka blerë naftë me nga rreth 50-60 litra dhe gjithësej rreth 270 litra naftë, plotësohet figura e veprës penale në vazhdimësi Blerje, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenet 73 dhe 74 të KPRK-ës, ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në këtë aspekt si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i akuzuari ishte i gjendjes së dobët ekonomike, rrethanat fizike invalid civil i luftës, pranimin e fajësisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për kryerjen e veprës penale dhe pendimin e sinqertë dhe real. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjshmërisë penale.

Sipas bindjes së Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese që ka gjetur te i akuzuari, dhe ka vlerësuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale,

shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Për pikën II të dispozitivit konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, detyrohet i akuzuari A.G që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumën prej 30.00€ dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të akuzuarin A. G. të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Për pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par 1 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Për pikat I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-ës, gjykata ka vendosur që palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil.

Andaj duke u bazuar në të gjitha të cekurat më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.8/19, me datë 09.08.2021

Procesmbajtësja

Gjyqtari

Suzane Rudi

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.